

AKT THEMELIMI  
I  
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
"ALBANIAN MOTOR COMPANY" SH.P.K.



Sot më datë 11 Maj, 2004,

- INER Sh.p.k., një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, themeluar sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë, me seli në Rrugën Qemal Stafa, Pall. 188, Shk. 1, Ap. 2, Tiranë, Shqipëri (këtej e tutje "INER"), ligjërish e përfaqësuar nga Z. Adrian Dulaku, qytetar shqiptar, lindur në Tiranë, më 05.02.1960, banues në Rr. Pjetër Bogdani, nr. 24/4, Tiranë, me pasaportë nr. 0362863;

dhe

- DALEWEST LIMITED, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, themeluar sipas legjislacionit të Qipros, me seli në Julia House, 3 Themistocles Dervis Street, CY - 1066 Nicosia, Qipro (këtej e tutje "Dalewest Limited"), ligjërish e përfaqësuar nga Z. Benjamin Michael Feinberg, qytetar izraelit, lindur në Afrikën e Jugut, më 06.03.1969, banues në Izrael, me pasaportë nr. 8073428;

në përputhje me Ligjin Nr. 7638, datë 14.12.1992 "Për Shoqëritë Tregtare" dhe legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë, kanë vendosur të krijojnë një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emëruar "Albanian Motor Company" Sh.p.k. (këtej e tutje referuar edhe si "Shoqëria") duke nënshkruar këtë Akt Themelimi. Aktiviteti i kësaj Shoqërie do të rregullohet në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe Statutin e saj, i cili është pjesë përbërëse e këtij Akti Themelimi.

#### Neni 1 - Emërtimi i Shoqërisë

Emërtimi i Shoqërisë është "Albanian Motor Company" Sh.p.k.

#### Neni 2 - Selia

Selia e Shoqërisë është në Qendrën Ford, Kashar, Tiranë, Shqipëri.

#### Neni 3 - Kohëzgjatja

- 3.1. Kohëzgjatja e aktivitetit të Shoqërisë do të jetë deri më 31 dhjetor 2100, duke filluar nga dita e regjistrimit të saj në Regjistrin e Shoqërive Tregtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.
- 3.2. Shoqëria mund të zgjasë kohëzgjatjen e saj dhe ajo mund të likuidohet apo prishet përpara këtij afati me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

#### Neni 4 - Objekti

4.1 Shoqëria ka për objekt:

- a) importimin, eksportimin, transportimin, shitjen, leasing, qiramarrjen apo qiradhënien dhe të gjitha operacionet e tjera tregtare që lidhen me automjetet tregtare dhe industriale, të çdo tipi dhe modeli;
- b) importimin dhe eksportimin, duke përfshirë importimin dhe eksportimin e lëndëve të para, pajisjeve, pjesëve të këmbimit, mallrave dhe materialeve të çdo lloji;
- c) transportimin, duke përfshirë transportimin kombëtar dhe ndërkombëtar të çdo lloji për qëllimet e Shoqërisë dhe për llogari të të tretëve;
- d) aktivitete tregtare, duke përfshirë por duke mos u kufizuar vetëm me shitjen me shumicë dhe pakicë të lëndëve të para, pajisjeve, pjesëve të këmbimit, mallrave dhe materialeve të çdo lloji;



- e) qiramarrjen dhe qiradhënien dhe leasing e pasurive, produkteve, mallrave dhe materialeve të çdo lloji, qofshin këto të luajshme apo të paluajshme;
  - f) pjesëmarrjen dhe organizimin e ekspozitave, panairove dhe/ose aktiviteve të ngjashme;
  - g) aktivitete komisionuese, agjenti, konsultimi në fusha të ndryshme, përfaqësimi dhe kryerje transaksionesh;
  - h) aktivitete investuese, duke përdorur fonde nga institucione financiare vëndase apo të hauaja;
  - i) çdo aktivitet tjetër që konsiderohet i dobishëm nga organi administrues i Shoqërisë, që lidhet direkt apo indirekt me aktivitetet e mësipërme.
- 4.2 Me qëllim përmbushjen e objektit të saj dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar, Shoqëria mund:
- a) të kryejë çdo transaksion që lidhet me pasuritë e luajshme dhe të paluajshme, si dhe çdo aktivitet tregtar financiar, qiramarrje apo qiradhënie, apo aktivitet hipotekimi apo të vënies peng, të cilët mund të konsiderohen si të dobishëm apo të nevojshëm me qëllim përmbushjen e objektit të Shoqërisë, me kusht që këto aktivitete të mos kalojnë madhësinë e aktiviteve kryesore të cituara më lart;
  - b) të kryejë publikime dhe aktivitete reklamuese;
  - c) lëshojë letra me vlerë dhe garanci të çdo lloji, duke përfshirë garanci për pagimin e kambialeve;
  - d) të fitojë, direkt apo indirekt, interesa në shoqëri të tjera të cilat kanë një objekt ngjashëm me atë të Shoqërisë, në Shqipëri apo jashtë saj.

### Neni 5 – Kapitali i Shoqërisë – Kontributet


- 5.1 Kapitali i Shoqërisë është 100.000 (njëqindmijë) lekë, i përbërë nga 100 (njëqind) pjesë kapitali me një vlerë nominale prej 1.000 (njëmijë) lekë secila.
- 5.2 Në momentin e themelimit, kapitali i Shoqërisë është nënshkruar dhe paguar plotësisht si më poshtë vijon:
- INER Sh.p.k., një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, themeluar sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë, me seli në Rrugën Qemal Stafa, Pall. 188, Shk. 1, Ap. 2, Tiranë, Shqipëri, ka kontribuar me para në kapitalin e Shoqërisë me një shumë të barabartë me 75.000 (shtatëdhjetëepesëmijë) lekë, nëpërmjet depozitimit të kësaj shume në llogarinë bankare nr. 402036172 hapur pranë Degës nr. 2 të Bankës Kombëtare Tregtare Sh.A në Tiranë.
  - DALEWEST LIMITED, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, themeluar sipas legjislacionit të Qipros, me seli në Julia House, 3 Themistocles Dervis Street, CY – 1066 Nicosia, Qipro, ka kontribuar me para në kapitalin e Shoqërisë me një shumë të barabartë me 25.000 (njëzetepesëmijë) lekë, nëpërmjet depozitimit të kësaj shume në llogarinë bankare nr. 402036172 hapur pranë Degës nr. 2 të Bankës Kombëtare Tregtare Sh.A në Tiranë.
- 5.3 Në bazë të kontributeve të sipërcituara, në momentin e themelimit:
- INER Sh.p.k. zotëron 75 (shtatëdhjetëepesë) pjesë kapitali, të barabarta me 75% (shtatëdhjetëepesë përqind) të kapitalit themeltar;
  - DALEWEST LIMITED zotëron 25 (njëzetepesë) pjesë kapitali, të barabarta me 25% (njëzetepesë përqind) të kapitalit themeltar.

### Neni 6 – Transferimi i Kapitalit

Pjesët e kapitalit mund të transferohen tërësisht apo pjesërisht sipas procedurave të parashikuara në Nenin 8 të Statutit.

### Neni 7 – Administratorët

- 7.1. Shoqëria administrohet nga 2 (dy) administratorë, edhe jo ortakë, të cilët do të emërohen apo shkarkohen nga Asambleja e Ortakëve.

 Faqja 2 nga 3

- 7.2. Administratori emërohet nga Asambleja e Ortakëve për një periudhë prej 3 (tre) vjetësh me të drejtë rizgjedhjeje për periudhat që pasojnë.
- 7.3. Me anë të këtij akti emërohen si administratorë të Shoqërisë personat e mëposhtëm:
- Z. Ilia Çili, qytetar shqiptar, lindur në Tiranë, më 17.03.1961, banues në Tiranë, me pasaportë nr. 1507179;
  - Z. Stanco Radic, qytetar britanik, lindur në Londër, Angli, më 20.06.1964, banues në Beograd, Sebi, me pasaportë nr. 704695921.
- 7.4. Në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe dispozitat e Statutit, Administratorët kanë të gjitha kompetencat e administrimit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm, të nevojshme për përmbushjen e objektit të Shoqërisë, përveç atyre kompetencave që ligji apo Statuti ia rezervon Asamblesë së Ortakëve. Administratorët mund t'ia delegojnë kompetencat e tyre personave të tretë mbi bazë të një prokure.
- 7.5. Administratorët kanë të drejtë të kryejnë, personalisht ose duke i deleguar personave të tretë, të gjitha procedurat që lidhen me regjistrimin e Shoqërisë si person juridik pranë organit kompetent. Ata janë të autorizuar të veprojnë për llogari të Shoqërisë derisa regjistrimi i saj pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë të ketë përfunduar.
- 7.6. Në bazë të paragrafit 11.2 të Statutit të Shoqërisë, me anë të këtij Akti Themelimi, Z. Ilia Çili i jipen të gjitha kompetencat për të vepruar veçmas në lidhje me aktivitetet dhe brenda kufijve të parashikuar në paragrafin 11.3 të Statutit të Shoqërisë.

### Neni 8 - Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

- 8.1. Çdo mosmarrëveshje që lind ndërmjet ortakëve në lidhje me këtë Akt Themelimi apo Shoqërinë (përveç atyre personale apo që nuk kanë të bëjnë me Shoqërinë), do të zgjidhen në mënyrë miqësore dhe do të diskutohen në mënyrë të drejtpërdrejtë ndërmjet palëve të interesuara.
- 8.2. Në rast se nuk arrihet në një zgjidhje miqësore të mosmarrëveshjes, ajo do t'i besohet Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, përveç kur një nga ortakët vendos të kërkojë zgjidhjen e mosmarrëveshjes nga një Gjykatë Arbitrazhi sipas procedurës së përcaktuar në Statutin e Shoqërisë.

### Neni 9 - Gjuha

Ky Akt Themelimi është hartuar në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe duke i bashkëngjitur edhe kopjen në anglisht. Për çdo mosmarrëveshjet në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e këtij Akti, versioni shqip do të jetë i vetmi me fuqi ligjore.

### Neni 10 - Dispozita të Fundit


Për çdo çështje që nuk rregullohet posaçërisht nga ky Akt Themelimi, do të zbatohen dispozitat e Statutit të Shoqërisë dhe Ligjit për Shoqëritë Tregtare.

Lexuar, nënshkruar dhe miratuar

Tiranë, 11 Maj 2004


NËNSHKRUAR

DALEWEST LIMITED

  
(Z. Benjamin Michael Feinberg  
përfaqësues i posaçëm)



INER

  
(Z. Adrian Dulaku  
përfaqësues i posaçëm)



STATUT  
I  
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
"ALBANIAN MOTOR COMPANY" SH.P.K.



TITULLI I  
EMËRTIMI I SHOQËRISË - SELIA - KOHËZGJATJA

**Neni 1 - Emërtimi i Shoqërisë**

- 1.1 Është themeluar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e quajtur "ALBANIAN MOTOR COMPANY" SH.P.K. (këtej e tutje referuar edhe si "Shoqëria").
- 1.2 Shoqëria ka vulën dhe logon e saj zyrtare.

**Neni 2 - Registered Office**

- 2.1 Selia e Shoqërisë është në Qendrën Ford, Kashar, Tiranë, Shqipëri.
- 2.2 Asambleja e Ortakëve mund të hapë apo mbyllë degë dhe/ose zyra përfaqësimi, në Shqipëri apo jashtë saj.


**Neni 3 - Kohëzgjatja**

- 3.1. Kohëzgjatja e aktivitetit të Shoqërisë do të jetë deri më 31 dhjetor 2100.
- 3.2. Shoqëria mund të zgjasë kohëzgjatjen e saj me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

TITULLI II  
OBJEKTI

**Neni 4 - Objekti**

- 4.1 Shoqëria ka për objekt:
  - a) importimin, eksportimin, transportimin, shitjen, leasing, qiramarrjen apo qiradhënien dhe të gjitha operacionet e tjera tregatë që lidhen me automjetet tregtare dhe industriale, të çdo tipi dhe modeli;
  - b) importimin dhe eksportimin, duke përfshirë importimin dhe eksportimin e lëndëve të para, pajisjeve, pjesëve të këmbimit, mallrave dhe materialeve të çdo lloji;
  - c) transportimin, duke përfshirë transportimin kombëtar dhe ndërkombëtar të çdo lloji për qëllimet e Shoqërisë dhe për llogari të të tretëve;
  - d) aktivitete tregatë, duke përfshirë por duke mos u kufizuar vetëm me shitjen me shumicë dhe pakicë të lëndëve të para, pajisjeve, pjesëve të këmbimit, mallrave dhe materialeve të çdo lloji;
  - e) qiramarrjen dhe qiradhënien dhe leasing e pasurive, produkteve, mallrave dhe materialeve të çdo lloji, qofshin këto të luajtshme apo të paluajtshme;
  - f) pjesëmarrjen dhe organizimin e ekspozitave, panireve dhe/ose aktiviteteve të ngjashme;
  - g) aktivitete komisionuese, agjenti, konsultimi në fusha të ndryshme, përfaqësimi dhe kryerje transaksionesh;
  - h) aktivitete investuese, duke përdorur fonde nga institucione financiare vëndase apo të huaja;
  - i) çdo aktivitet tjetër që konsiderohet i dobishëm nga organi administrues i Shoqërisë, që lidhet direkt apo indirekt me aktivitetet e mësipërme.
- 4.2 Me qëllim përmbushjen e objektit të saj dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar, Shoqëria mund:
  - a) të kryejë çdo transaksion që lidhet me pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe çdo aktivitet tregtar financiar, qiramarrje apo qiradhënie, apo aktivitet hipotekimi apo të vënies peng, të cilët mund të konsiderohen si të dobishëm apo të nevojshëm me

- 
- qëllim përmbushjen e objektit të Shoqërisë, me kusht që këto aktivitete të mos kalojnë madhësinë e aktiviteteve kryesore të cituara më lart;
- b) të kryejë publikime dhe aktivitete reklamuese;
  - c) lëshojë letra me vlerë dhe garanci të çdo lloji, duke përfshirë garanci për pagimin e kambialeve;
  - d) të fitojë, direkt apo indirekt, interesa në shoqëri të tjera të cilat kanë një objekt të ngjashëm me atë të Shoqërisë, në Shqipëri apo jashtë saj.

### TITULLI III

## KAPITALI - RRRITJA DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT - TRANSFERIMI I PJESËVE TË KAPITALIT


### Neni 5 - Kapitali

- 5.1 Kapitali i Shoqërisë është 100.000 (njëqindmijë) lekë, i përbërë nga 100 (njëqind) pjesë kapitali me një vlerë nominale prej 1.000 (njëmijë) lekë secila.
- 5.2 Në momentin e themelimit, kapitali i Shoqërisë është nënshkruar dhe paguar plotësisht si më poshtë vijon:
  - a) INER Sh.p.k., një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, themeluar sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë, me seli në Rrugën Qemal Stafa, Pall. 188, Shk. 1, Ap. 2, Tiranë, Shqipëri, ka kontribuar me para në kapitalin e Shoqërisë me një shumë të barabartë me 75.000 (shtatëdhjetëpesëmijë) lekë, nëpërmjet depozitimit të kësaj shume në llogarinë bankare nr. 402036172 hapur pranë Degës nr. 2 të Bankës Kombëtare Tregtare Sh.A në Tiranë;
  - b) DALEWEST LIMITED, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, themeluar sipas legjislacionit të Qipros, me seli në Julia House, 3 Themistocles Dervis Street, CY - 1066 Nicosia, Qipro, ka kontribuar me para në kapitalin e Shoqërisë me një shumë të barabartë me 25.000 (njëzetepesëmijë) lekë, nëpërmjet depozitimit të kësaj shume në llogarinë bankare nr. 402036172 hapur pranë Degës nr. 2 të Bankës Kombëtare Tregtare Sh.A.
- 5.3 Në bazë të kontributeve të sipërcituara, në momentin e themelimit:
  - a) INER Sh.p.k. zotëron 75 (shtatëdhjetëpesë) pjesë kapitali, të barabarta me 75% (shtatëdhjetëpesë përqind) të kapitalit themeltar;
  - b) DALEWEST LIMITED zotëron 25 (njëzetepesë) pjesë kapitali, të barabarta me 25% (njëzetepesë përqind) të kapitalit themeltar.

### Neni 6 - Rritja e kapitalit

- 6.1 Asambleja e Ortakëve mund të rrisë pa kufizim kapitalin e Shoqërisë në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në këtë rast, vendimi duhet të merret gjithmonë me votën pro të Ortakëve që përfaqësojnë të paktën 90% (nëntëdhjetë përqind) të kapitalit. Vendimi do t'u njoftohet me shkrim Ortakëve që u thirrën por që nuk u paraqitën në mbledhjen e Asamblesë së Ortakëve që vendosi për rritjen e kapitalit.
- 6.2 Në rast rritje të kapitalit themeltar, të gjithë Ortakët do të kenë të drejtë të nënshkruajnë rritjen e tij në proporcion me pjesët e tyre në kapital. Të gjithë Ortakët do të njoftojnë me shkrim Shoqërinë dhe Ortakët e tjerë mbi vendimin e tyre për të ushtruar apo jo të drejtën e tyre brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e vendimit të rritjes së kapitalit, apo nëse ata nuk kanë qenë të pranishëm në mbledhjen e Asamblesë së Ortakëve që mori vendim rritjen e kapitalit, brenda të njëjtit afat nga marrja e njoftimit të cituar në paragrafin e mësipërm 6.1. Nëse ndonjëri prej Ortakëve nuk e jep këtë njoftim brenda afatit të parashikuar, do të konsiderohet se ai ka hequr dorë nga e drejta e tij.
- 6.3 Në rast se disa Ortakë heqin dorë nga e drejta e tyre për të nënshkruar në proporcion me pjesët e tyre, kapitali i panënshkruar mund të nënshkruhet nga Ortakët e tjerë të cilët e kanë njoftuar vendimin për të ushtruar të drejtën e tyre. Në këtë rast, këta Ortakë mund të ri-ushetrojnë të drejtën për nënshkrim për pjesët e kapitalit të panënshkruara, në proporcion





me pjesët e tyre nëse bëhet fjalë për disa Ortakë, apo totalisht nëse bëhet fjalë vetëm për një Ortak.

Në rast se Ortakët nuk e nënshkruajnë plotësisht kapitalin e rritur, pjesa e kapitalit e panënshkruar mund të nënshkruhet nga persona të tretë.

### Neni 7 - Zvogëlimi i Kapitalit

- 7.1 Asambleja e Ortakëve mund të zvogëlojë kapitalin e Shoqërisë në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Në këtë rast vendimi duhet gjithmonë të merret me votën pro të Ortakëve që përfaqësojnë të paktën 90% (nëntëdhjetë përqind) të kapitali themeltar. Në çdo rast kapitali i Shoqërisë nuk mund të zvogëlohet nën kufirin e parashikuar me ligj.
- 7.2 Ortakët marrin pjesë në zvogëlimin e kapitalit themeltar në proporcion me pjesët e tyre në kapitalin themeltar.

### Neni 8 - Transferimi i Pjesëve të Kapitalit

- 8.1 Ortaku që merr një ofertë dhe/ose dëshiron të transferojë *inter vivos*, totalisht apo pjesërisht, pjesët e tij të kapitalit në Shoqëri, në favor të të tretëve apo Ortakëve të tjerë në Shoqëri, do t'i dërgojë një njoftim me shkrim me postë rekomande si Ortakëve të tjerë ashtu edhe Shoqërisë (këtë e tutje "Njoftimi"), duke specifikuar në të, të gjitha kushtet dhe afatet e ofertës.
- 8.2 Çdo transferim i parashikuar në nenin 8.1 do t'i nënshtrohet fillimisht të drejtës së parablerjes në favor të Ortakëve të tjerë. Ortakët e tjerë që dëshirojnë të ushtrojnë të drejtën e parablerjes do të njoftojnë me postë rekomande Ortakun që dëshiron të transferojë pjesët e tij të kapitalit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga marrja e Njoftimit, mbi vendimin e tyre të përvokueshëm për të ushtruar të drejtën e parablerjes (këtë e tutje "Komunikimi"). Nëse ndonjëri prej Ortakëve nuk përgjigjet brenda afatit të mësipërm, do të konsiderohet se ai ka hequr dorë nga e drejta e tij.
- 8.3 Nëse ndonjëri prej Ortakëve refuzon apo heq dorë nga e drejta e tij e parablerjes, Ortakët e tjerë që kanë ushtruar të drejtën e tyre të parablerjes mund të ri-ushtrojnë të drejtën e tyre për pjesët e kapitalit ofruar Ortakut që refuzoi apo hoqi dorë.
- 8.4 Nëse disa Ortakë dëshirojnë të ushtrojnë apo ri-ushtrojnë të drejtën e tyre të parablerjes, sipas paragrafëve të mësipërm 8.2 dhe 8.3, pjesët e kapitalit do të shpërndahen në përpjestim me pjesët e tyre në kapital. Nëse vetëm një prej Ortakëve dëshiron të ushtrojë apo të ri-ushtrojë të drejtën e tij të parablerjes, pjesët e kapitalit të ofruara do t'i transferohen tërësisht atij.
- 8.5 Në rast të ushtrimit apo ri-shtrimit të drejtës së parablerjes, kontrata e shitjes së pjesëve të kapitalit duhet të nënshkruhet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja e Komunikimit, me kushtet dhe afatet e cituara në Njoftim. Pjesët e kapitalit që nuk i transferohen Ortakëve të tjerë sipas paragrafëve të mësipërm 8.2 dhe 8.3 mund të transferohen lirisht por në përputhje me paragrafin e mëposhtëm 8.6. dhe sipas legjislacionit në fuqi. Në këtë rast, vlefshmëria dhe hyrja në fuqi e këtij transferimi në raport me Shoqërinë do të kushtëzohet nga pikat e mëposhtme:
  - kontrata për transferimin e pjesëve të kapitalit do të nënshkruhet brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve nga marrja prej Shoqërisë e Njoftimit, në përputhje me të gjitha kushtet dhe afatet e cituara në Njoftim;
  - një kopje e kësaj kontrate do t'i jipet Shoqërisë jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë nga data e nënshkrimit të saj, kopje e cila do të vihet në dispozicion të Ortakëve.
- 8.6 Pjesët e kapitalit mund t'i transferohen të tretëve, tërësisht apo pjesërisht, vetëm me miratimin e Asamblesë së Ortakëve dhe sipas dispozitave ligjore në fuqi. Në këtë rast, vendimi duhet të merret me shumicë të Ortakëve që përfaqësojnë të paktën 90% (nëntëdhjetë përqind) të kapitalit. Në rast se Asambleja e Ortakëve refuzon të japë miratimin për transferimin e pjesëve të kapitalit në favor të ndonjë prej Ortakëve, Ortakët e tjerë janë të detyruar t'i blejnë vetë këto pjesë kapitali, sipas kushteve dhe afateve të cituara në Njoftim.

TITULLI IV  
ASAMBLEJA E ORTAKËVE - ADMINISTRATORËT - KONTROLLI

**Neni 9 - Asambleja e Ortakëve**

- 9.1. Çdo Ortak ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet e Asamblesë së Ortakëve, të shprehë mendimin e tij dhe të votojë në përputhje me pjesët e kapitalit të zotëruara prej tij.
- 9.2. Çdo Ortak ka të drejtë të caktojë në Asamblenë e Ortakëve një përfaqësues, Ortak apo person të tretë, mbi bazën e një prokure me shkrim.
- 9.3. Ortaku nuk mund të delegojë të drejtën e tij të votës për një pjesë të kuotës së zotëruar prej tij në rast se ai vet voton personalisht për pjesën tjetër.

**Neni 10 - Mbledhjet e Asamblesë së Ortakëve**

- 10.1. Asambleja e Ortakëve mund të mbahet në Republikën e Shqipërisë apo jashtë saj.
- 10.2. Asambleja e Ortakëve thirret nga administratori apo administratorët me anë të një njoftimi dërguar me postë rekomande. Kjo letër duhet t'i dërgohet Ortakëve në adresat e komunikuar Shoqërisë, dhe ekspertit kontabël (nëse është emëruar), të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) ditë përpara mbledhjes. Njoftimi duhet të përmbajë rendin e ditës që do të diskutohet, vendin, kohën dhe ditën e parë dhe të dytë të mbajtjes së mbledhjes.
- 10.3. Asambleja e Ortakëve do të konsiderohet se është thirrur rregullisht, pavarësisht nga respektimi i formaliteteve, nëse janë të pranishëm të gjithë Ortakët apo përfaqësuesit e tyre.
- 10.4. Asambleja e Ortakëve cakton një kryetar dhe një sekretar për çdo mbledhje, të zgjedhur nga personat e pranishëm.
- 10.5. Mbledhjet e Asamblesë së Ortakëve do të zhvillohen në gjuhën angleze dhe të gjitha dokumentat e materialet e shpërndara për këtë mbledhje do të jenë në anglisht ose do të kenë bashkangjitur përkthimin anglisht. Vendimet e Asamblesë së Ortakëve duhet të merrren me shkrim dhe të nënshkruhen nga kryetari dhe sekretari. Vendimet duhet të përfshijnë edhe deklaratimet e Ortakëve nëse këto kërkohen prej tyre.
- 10.6. Asambleja e Ortakëve thirret të paktën një herë në vit brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar me qëllim që të miratojë inventarin dhe bilancin, raportin e administratorit apo administratorëve dhe raportin e ekspertit kontabël (nëse është emëruar).
- 10.7. Asambleja e Ortakëve do të konsiderohet se është mbledhur rregullisht dhe se mund të marrë vendime të vlefshme nëse është i pranishëm më shumë se 50% (pesëdhjetë përqind) i kapitalit themeltar, përveç kur bëhet fjalë për rastet e parashikuara në paragrafin e mëposhtëm 10.8. Nëse nuk arrihet ky quorum, Asambleja njoftohet për thirrjen e dytë, në të cilën ajo mund të vendosë me shumicë të thjeshtë pavarësisht nga numri i Ortakëve të pranishëm apo të përfaqësuar, përveç kur bëhet fjalë për rastet e parashikuara në paragrafin e mëposhtëm 10.8.
- 10.8. Asambleja e Ortakëve merr vendim për ndryshimin e këtij statuti me votën pro të Ortakëve që përfaqësojnë të paktën 90% (nëntëdhjetë përqind) të kapitalit.

**Neni 11 - Administratorët**

- 11.1. Shoqëria administrohet nga së paku 1 (një) dhe maksimumi 7 (shtatë) administratorë, të cilët mund të jenë edhe jo Ortakë, të emëruar, për një afat prej 3 (tre) vitesh, nga Asambleja e Ortakëve, ose nga Akti i Themelimit për administratorët e caktuar për herë të parë. Në fund të këtij afati, administratori apo administratorët mund të rizgjidhen apo shkarkohen.
- 11.2. Administratorët kanë së bashku të gjitha kompetencat e administrimit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të Shoqërisë, përveçse kur Asambleja e Ortakëve, apo Akti i Themelimit për administratorët e zgjedhur për herë të parë, vendos apo parashikon se një apo disa administratorë kanë të drejtë të veprojnë veçmas, në përputhje me parashikimet e paragrafëve të mëposhtëm 11.3 dhe 11.4.



11.3 Në rast se një apo disa administratorë kanë të drejtë të veprojnë veçmas dhe në mënyrë të pavarur sic parashikohet në paragrafin e mësipërm 11.2, administratori/ët do të kenë të gjitha kompetencat për të vepruar veçmas dhe individualisht në emër dhe për llogari të Shoqërisë, vetëm për aktivitetet e mëposhtme dhe brenda kufijve të caktuar:

- a) për të lidhur, ndryshuar, zgjidhur dhe transferuar kontrata shitje apo blerje, leasing, qiradhënie apo qiramarrje, dhe/ose çdo kontratë tjetër, duke përfshirë por pa u kufizuar vetëm në kontrata financiare apo bankare për dhënie apo marrjen e garancive, kolateralëve dhe barrëve në lidhje me furnizimin e automjeteve Ford, pjesëve të këmbimit origjinale Ford, aksesoreve dhe produkteve dhe/ose shërbimeve që lidhen me to, brenda kufirit të 30.000.000 (tridhjetëmilion) Lekë-ve për çdo kontratë, dhe brenda kufirit të 500.000.000 (pesëqindmilion) Lekë-ve për çdo muaj kalendarik. Fjala Ford e përcaktuar këtu do të thotë automjete të familjes Ford;
- b) për të lidhur, ndryshuar, zgjidhur dhe transferuar kontrata të çdo lloji apo tipi, përveç kontratave të parashikuar në gërmën e mësipërme a), duke përfshirë por duke mos u kufizuar vetëm në kontratat e punësimit, blerjes dhe shitjes së produkteve dhe/ose shërbimeve, leasing, factoring, transportimit, sigurimit, agjencisë, prokurimit, depozitës dhe çdo kontratë tjetër që lidhet me aktivitetin operacional të Shoqërisë, brenda kufirit të 2.500.000 (dymilion e pesëqindmijë) Lekë-ve për çdo kontratë, dhe brenda kufirit të 12.500.000 (dymbëdhjetëmilion e pesëqindmijë) Lekë-ve për çdo muaj kalendarik;
- c) për të hapur llogari bankare dhe depozita, dhe për të kryer operacione të çdo lloji natyre apo tipi me këto llogari apo depozita, brenda kufirit të 2.500.000 (dymilion e pesëqindmijë) Lekë-ve për çdo operacion, dhe brenda kufirit të 12.500.000 (dymbëdhjetëmilion e pesëqindmijë) Lekë-ve për çdo muaj kalendarik;
- d) për të aplikuar për kredi, kredi bankare, hua bankare, discounts dhe shlyerje debish, brenda kufirit të 2.500.000 (dymilion e pesëqindmijë) Lekë-ve për çdo operacion, dhe brenda kufirit të 12.500.000 (dymbëdhjetëmilion e pesëqindmijë) Lekë-ve për çdo muaj kalendarik;
- e) për të lëshuar, transferuar dhe/ose transferuar çeqe, premtim pagesa, kambiale, çeqe bankar dhe urdhër-pagesa, me qëllim urdhërimin e transferimit të parave dhe dhënies së kredive, brenda kufirit të 2.500.000 (dymilion e pesëqindmijë) Lekë-ve për çdo operacion, dhe brenda kufirit të 12.500.000 (dymbëdhjetëmilion e pesëqindmijë) Lekë-ve për çdo muaj kalendarik;
- f) për të kërkuar pagimin e kredive të çdo lloji dhe shume, qofshin këto nga persona privatë apo publikë;
- g) për të nënshkruar dhe marrë miratime bankare që lidhen me operacione import-eksportesh;
- h) për të nënshkruar dhe vulosur fatura, çertifikata, urdhra, aplikime dhe të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për operacionet e mësipërme;
- i) për të paraqitur përpara çdo autoriteti publik, duke përfshirë por pa u kufizuar vetëm në autoritetet gjyqësore, tatimore, të sigurimeve, dhomës së tregtisë, ministrive, etj., çdo aplikim, propozim, pyetje, pretendim dhe çfarëdo lloj kërkesë tjetër që nevojitet për marrjen e licencave, konçesioneve apo autorizimeve në përgjithësi;
- j) për të ndërmarrë çdo aktivitet apo operacion tjetër që lidhet me objektin e Shoqërisë, brenda kufirit të 2.500.000 (dymilion e pesëqindmijë) Lekë-ve për çdo aktivitet apo operacion.

11.4 Për të gjitha ato aktivitetet që nuk përfshihen në listën e cituar në paragrafin e mësipërm 11.3, apo në rast se kalohen kufijtë e caktuar për to, administratorët do t'i ushtrojnë kompetencat bashkarisht. Në çdo rast, administratorët do të ushtrojnë bashkarisht të gjitha kompetencat për aktivitetet e mëposhtme:

- a) për të hyrë në transaksione, apo për të ekzekutuar ndonjë akt, që përfshin një person të tretë të lidhur, sipas kuptimit të Nenit 219 të Ligjit nr. 7638 për Shoqëritë Tregtare, apo që përfshin ndonjë administrator, ortak apo punonjës të Shoqërisë;





SHOQËRISË  
E SHKALLËS  
SË PARË  
TIRANË

- b) për të hyrë në transaksione, apo për të ekzekutuar ndonjë akt, që përfshin pasuri të paluajtshme të Shoqërisë, pavarësisht nga vlera e transaksionit apo e aktit;
  - c) për të blerë aksione apo pjesë kapitali në shoqëri të tjera;
  - d) për të marrë pjesë në themelimin e shoqërive të tjera, në Shqipëri apo jashtë saj;
  - e) për të blerë, nënshkruar apo fituar letra me vlerë dhe/ose detyrime qeveritare apo të shoqërive, si dhe letra të tjera me vlerë dhe/ose instrumenta financiarë, *debentures* apo derivatë të tij si *options, warrants, swaps*, derivatë kredie, *futures, forwards, interest rate caps, floors* dhe *collars*, etj., për një vlerë që kalon kufirin e 2.500.000 (dymilion e pesëqindmijë) Lekë-ve për çdo operacion, dhe kufirin prej 12.500.000 (dymbëdhjetëmilion e pesëqindmijë) Lekë-ve për çdo muaj kalendarik;
  - f) për të ndarë pasuritë e Shoqërisë, apo për të transferuar çdo pasuri apo biznes të Shoqërisë;
  - g) për të dhënë hua, kredi, discounts dhe çdo ofrim fondesh që përbën një kredi për Shoqërinë, vlera e së cilës kalon kufirin e 2.500.000 (dymilion e pesëqindmijë) Lekë-ve për çdo operacion, dhe kufirin prej 12.500.000 (dymbëdhjetëmilion e pesëqindmijë) Lekë-ve për çdo muaj kalendarik;
  - h) për të hipotekuar, vënë barrë apo peng ndonjë prej pasurive të Shoqërisë, apo për të dhënë ndonjë garanci tjetër për një vlerë që kalon kufirin e 2.500.000 (dymilion e pesëqindmijë) Lekë-ve për çdo operacion, dhe kufirin prej 12.500.000 (dymbëdhjetëmilion e pesëqindmijë) Lekë-ve për çdo muaj kalendarik;
  - i) për çdo operacion, transaksion, kërkesë, aplikim dhe/ose aktivitet tjetër që lidhet në përgjithësi me markat dhe të drejtat e tjera të pronësisë intelektuale të Shoqërisë.
- 11.5 Secili prej Ortakëve ka të drejtë të kontrollojë, në çdo kohë dhe pa kufizim, aktet e kryera nga administratorët, kontroll të cilin ai mund t'a kryejë personalisht, apo kur ai e çmon të nevojshme, nga një përfaqësues i tij.

#### Neni 12- Eksperti kontabël

- 12.1. Nëse është e nevojshme ose kërkohet nga ligjit, kontrolli i bilancit dhe librave të kontabilitetit të Shoqërisë do t'i besohet një eksperti kontabël, emëruar për një periudhë 6 (gjashtë) vjeçare me mundësinë për tu rizgjedhur për një periudhë tjetër nga Asambleja e Ortakëve.
- 12.2. Eksperti kontabël i autorizuar mund të shkarkohet me të njëjtën procedurë.

### TITULLI V VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, SHPËRNDARJA E FITIMEVE

#### Neni 13 - Viti Financiar dhe Bilanci Vjetor

- 13.1. Viti financiar fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor të secilit vit.
- 13.2. Viti i parë financiar fillon në datën e regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë dhe përfundon më 31 dhjetor të të njëjtit vit.
- 13.3. Bilanci vjetor, llogaritë financiare, inventari, raportet e Administratorëve dhe ekspertit kontabël të autorizuar (nëse është emëruar) miratohen nga Asambleja e Ortakëve.
- 13.4. Dokumenta që lidhen me vitin financiar duhet të miratohen brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar.



#### Neni 14 - Fitimet

- 14.1. Pasi janë zbritur 5% (pesë përqind) për rezervën ligjore deri në 10% (dhjetë përqind) të kapitalit themeltar, dhe pasi janë zbritur gjithashtu të gjitha shumat që Asambleja e Ortakëve vendos t'i vëre mënjane, fitimet që rezultojnë nga bilanci vjetor u shpërndahen Ortakëve në proporcion me pjesët e kapitalit themeltar të zotëruara prej tyre.
- 14.2. Asambleja e Ortakëve mund të vendosë, për qëllime të posaçme, krijimin e rezervave të posaçme apo të jashtëzakonshme apo ajo mund të vendosë edhe shtyrjen e shpërndarjes së fitimeve, tërësisht apo pjesërisht.

### TITULLI VI SHPËRNDARJA DHE LIKUJDIMI

#### Neni 15 - Shpërndarja

- 15.1. Shoqëria mund të shpërndahet me vendim të Asamblesë së Ortakëve, i cili duhet të merret me votën pro të Ortakëve që përfaqësojnë të paktën 90% (nëntëdhjetë përqind) të kapitalit, apo në rastet e parashikuara nga ligji.
- 15.2. Shoqëria nuk shpërndahet në rast të paaftësisë për të vepruar, vdekjes, likuidimit apo falimentimit të Ortakëve.

#### Neni 16 - Likuidimi

- 16.1. Në rast të prishjes, Shoqëria duhet të likujdohet.
- 16.2. Për të administruar këtë procedurë, Asambleja e Ortakëve emëron një ose disa likuidatorë, të cilët do të paraqesin raportin përfundimtar mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivitetit të Shoqërisë, mbi operacionet e likuidimit dhe mbi kohën e nevojshme për të përfunduar likuidimin.
- 16.3. Me përfundimin e procedurës së likuidimit, Asambleja e Ortakëve merr vendim lidhur me bilancin përfundimtar, punën e kryer nga likuiduesi/t dhe përfundimin e procesit të likuidimit.
- 16.4. Pas pagesës së kreditorëve dhe mbledhjes së kredive, likuidatori/ët do t'ia shpërndajnë fitimin që mbetet pas likuidimit Ortakëve, në proporcion me pjesët e kapitalit të zotëruara prej tyre.

#### Neni 17 - Transformimi i Shoqërisë

Shoqëria mund të shndërrohet në shoqëri kolektive vetëm me miratimin unanim të Ortakëve, si dhe ajo mund të shndërrohet në shoqëri aksionere me votën pro të Ortakëve që përfaqësojnë të paktën 90% (nëntëdhjetë përqind) të kapitalit themeltar.

#### Neni 18 - Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

- 18.1. Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e këtij Statuti, si edhe ato që mund të lindin midis Ortakëve ose midis një apo disa Ortakëve dhe Shoqërisë, do të zgjidhen në mënyrë miqësore dhe do të diskutohen në mënyrë të drejtpërdrejtë ndërmjet palëve të interesuara.
- 18.2. Në rast se nuk arrihet në një zgjidhje miqësore të mosmarrëveshjes, ajo do t'i besohet vetëm Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, përveç kur ndonjë prej Ortakëve vendos t'ia nënshtrojë zgjidhjen e mosmarrëveshjes Gjykatës së Arbitrazhit.
- 18.3. Arbitrazhi do të përbëhet prej 3 anëtarësh, dy prej të cilëve emërohen respektivisht prej palëve, dhe i treti, në funksionin e kryetarit, emërohet me marrëveshje të përbashkët nga

dy arbitrat. Nëse një marrëveshje e tillë nuk arrihet, brenda 20 (njëzet) ditëve pas caktimit të dy arbitrave të parë, Kryetari i Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, mbi bazën e kërkesës prej palës më të interesuar, do të caktojë arbitrin e tretë. Kryetari i Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë do të ketë gjithashtu të drejtën për të caktuar arbitrin e palës, i cili nuk është zgjedhur nga pala në fjalë brenda 20 (njëzet) ditëve nga marrja e kërkesës për procedurën e arbitrazhit nga pala tjetër.

- 18.3. Gjykata e Arbitrazhit do të zbatojë ligjin shqiptar.
- 18.4. Gjykata e Arbitrazhit do të marrë vendimin e saj brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve nga dita që arbitri i fundit ka pranuar detyrën. Ky afat mund të zgjatet vetëm një herë, me marrëveshje të përbashkët të shkruar të Gjykatës së Arbitrazhit, për një periudhë jo më të gjatë se 90 (nëntëdhjetë) ditë.
- 18.5. Arbitrazhi do të vendosë në bazë të ligjit dhe vlerësimi i tij, duke qenë i detyrueshëm për palët, si një shprehje e vullnetit të tyre, nuk do të jetë subjekt i ndonjë apelimi apo kundërshtimi.
- 18.6. Vendi i arbitrimit do të jetë Tirana. Gjuha e arbitrimit do të jetë ajo shqiptare.

### Neni 19 - Gjuha


Ky Statut është hartuar në 4 (katër) kopje në gjuhën shqipe duke i bashkëngjitur edhe kopjen në anglisht. Për çdo mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e këtij Akti, versioni shqip do të jetë i vetmi me fuqi ligjore.

Lexuar, nënshkruar dhe miratuar

Tiranë, 11 Maj 2004


NËNSHKRUAR

DALEWEST LIMITED

  
(Z. Benjamin Michael Feinberg  
përfaqësues i posaçëm)



INER

  
(Z. Adrian Dulaku  
përfaqësues i posaçëm)

